



Projekti: Përforcimi i kapaciteteve administrative për zbatimin e kornizës ligjore për falimentim dhe likuidim të shoqërive tregtare

Tryeza e dytë e rumbullakët

„Transferimi i pronës që është në pronësi të subjekteve juridike në kushte të likuidimit dhe fshirjes sipas detyrës zyrtare – probleme në praktikë“

Më 11 prill 2017 u organizua tryeza e dytë e rumbullakët kushtuar likuidimit, në kuadër të projektit „Përforcimi i kapaciteteve administrative për zbatimin e kornizës ligjore për falimentim dhe likuidim të shoqërive tregtare“, me temë: „ Transferimi i pronës që është në pronësi të subjekteve juridike në kushte të likuidimit dhe fshirjes sipas detyrës zyrtare – probleme në praktikë„, ku diskutuan përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë, të Agjencisë së Kadastrës për Patundshmëri, të Drejtorisë së të Ardhurave Publike, të Regjistrimit Qendror, të Odës së Noterëve dhe palë të tjera të interesuara.



U diskutua mbi mënyrën e zbatimit të dispozitave ligjore gjatë transferimit të patundshmërive në Agjencinë për Kadastër të Patundshmërive dhe regjistrimit të ndryshimeve në regjistrin kadastral, si dhe mbi afatet për organizmin e pasurisë së luajtshme, të paluajtshme dhe mjeteve në të holla, shikuar nga aspekti i Drejtorisë për të Ardhura Publike, kur është fjala për shlyerjen e detyrimeve tatimore gjatë transferimit. U hapën edhe çështjet që dalin nga kohëzgjatja e afateve të fshirja e subjekteve tregtare sipas detyrës zyrtare. Gjegjësisht, fshirja zbatohet në përputhshmëri me Nenet 447-a, 552-a dhe 552-b të Ligjit për shoqëri tregtare, në atë mënyrë që prona e luajtshme e shoqërive tregtare shpërndahet brenda një viti, ndërsa mjetet në të holla dhe patundshmëria brenda dhjetë viteve nga dita e sjelljes së vendimit për fshirje. U dha definimi se nëse pas skadimit të afateve nuk bëhet shpërndarja, prona transferohet në pronësi të Republikës së Maqedonisë, me detyrimin që prona e luajtshme të ruhet për një vit, ndërsa patundshmëria dhe mjetet në të holla për 10 vite, por nuk është precizuar mënyra se si do të arrihet kjo dhe çfarë ndodh me harxhimet eventuale.

Pjesëmarrësit në diskutim u zotuan për përmirësimin e mëtejshëm të legjislacionit në drejtim të definimit të një subjekti apo procedure të caktuar me të cilën do të rregullohej koordinimi dhe do të përmirësohej kontrolli mbi likuidimin nga aspekti i sigurimit të transferimit a tjetërsimit të pronës së shoqërisë tregtare para përfundimit të plotë të procedurës. Do të nevojitet gjetja e zgjidhjeve për pronën që është në pronësi të subjekteve juridike në rast të fshirjes sipas detyrës zyrtare.

Projekti „Përforcimi i kapaciteteve administrative për zbatimin e kornizës ligjore për falimentim dhe likuidim të shoqërive tregtare“ realizohet me mjete të Instrumentit për Asistencë Para-Aderimit (IPA) të Bashkimit Evropian ndërsa zbatohet nga ana e konsorciumit të udhëhequr nga Pohl Consulting & Associates, në partneritet me Ernst&Young.

Shkup, 11.04.2017